



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:286131
Datë: 14.09.2021
Numri i dokumentit: 02169222

Pml.nr.280/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit N.A, për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile sipas nenit 142 dhe 22 të Ligjit Penal të ish RSFJ-së lidhur me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12.08.1949, nenin 4 par.2 pika a, e dhe g të Protokollit II të datës 08.06.1977 shtojcë e Konventave të Gjenevës, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.55/2019 të datës 24.12.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.11/2021 të datës 12.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06 shtator 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit N.A e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.55/2019 të datës 24.12.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti Special APS.nr.11/2021 të datës 12.05.2021.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.55/2019 e datës 24.12.2020, të dënuarin N.A, e ka shpallur fajtor për veprën penale krime lufte kundër popullatës civile sipas nenit 142 dhe 22 të Ligjit Penal të ish RSFJ-së lidhur me nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12.08.1949, nenin 4 par.2 pika a, e dhe g të Protokollit II të datës 08.06.1977 shtojcë e Konventave të Gjenevës, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite, në të cilin dënim është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.10.2019 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 500 €, si dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.11/2021 e datës 12.05.2021, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të dënuarit dhe mbrojtësit të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Dejan Vasiç nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza për veprën penale për të cilën është gjykuar ose aktgjykimet e kundërshtuara ti anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të shkallës së dytë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.173/2021 e datës

10.08.2021, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë nuk është dhënë arsyetim sipas pretendimeve ankimore dhe me këtë rast është shkelur dispozita e nenit 404 par.1 të KPPK-së, dhe tërë arsyetimi bazohet në përsëritjen e gjendjes faktike dhe të gjeturat sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë mënyrë pretendohet se është shkelur dispozita e nenit 370 par.7 të KPPK-së, për faktin se deklaratimet kontradiktore të të dëmtuarve J. dhe S.Sh, nuk janë arsyetuar mjaftueshëm. Theksohet fakti se deklaratimet kontradiktore të të dëmtuarve të sipër cekur nuk arsyetohen përkundër faktit se në ankesën e paraqitur në mënyrë të detajuar janë theksuar dallimet e deklaratimeve të tyre duke filluar nga kallëzimi penal, deklaratimet e dhëna në polici, deklaratimet para prokurorit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Posaçërisht faktet se në kallëzimin penal të paraqitur nga ana e të dëmtuarve ishte përshtetur se i dënuari kur shkoi në shtëpinë e tyre filloi maltretimin e personave të cilët i ka takuar aty dhe pastaj i ka rrahur gratë, pleqtë dhe fëmijët, mirëpo pastaj janë tërhequr nga këto deklaratime.

Në deklaratimet e mëvonshme të dëmtuarit kanë theksuar faktin se i dënuari menjëherë pas hyrjes në kopsht ka filluar me rrahje, por më vonë deklarojnë se rrahjen e ka bërë një rom. Kurse më tutje në deklaratimet e dhëna para prokurorit i dëmtuari J.Sh, ka deklaruar se i dënuari vetëm një herë e ka goditur me shkop në dorë, kurse i dëmtuari S.Sh1, gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaron se nuk ishte i dënuari por një rom. Në këtë mënyrë pretendohet se bazuar në deklaratimet e të dëmtuarve mund të vihet në përfundim se nuk e flasin të vërtetën dhe deklaratimeve të tyre nuk mund tu besohet dhe pikërisht për arsye të kontradiktave të dëshmitë të tyre ekzistojnë shkelje të dispozitës së nenit 370 par.7 të KPPK-së të cilat kontradikta do të duhej ti eliminonin gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë nuk merr parasysh deklaratimet e mëparshme të të dëmtuarve gjatë procedurës penale, por vlerëson deklaratimet e tyre vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe vetëm pjesët në të cilat të dëmtuarit janë përgjigjur në pyetjet e prokurorit të shtetit dhe jo në pyetjet e mbrojtjes dhe me këtë është shkelur barazia e palëve në procedurë.

Pretendohet se edhe gjatë procedurës së identifikimit të të dënuarit nga ana e të dëmtuarve është bërë duke u bazuar në dëshmitë e tyre dhe se të njëjtit gjithashtu nuk kanë treguar të vërtetën

dhe se përkundër kësaj deklarimet e tyre janë çmuar si të besueshme nga ana e gjykatave. Përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë, konteston procedurën e identifikimit të të dënuarit bazuar në fotografitë e identifikimit, megjithatë gjykata e shkallës së dytë në tërësi e pranon këtë identifikim përkundër mangësive të shumta gjatë identifikimit dhe përkundër faktit se i dëmtuari S.Sh1, nuk e kishte identifikuar të dënuarin, mirëpo pastaj vëllai i tij i dëmtuari tjetër J.Sh, i kishte treguar fotografinë e të dënuarit për identifikim.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesa, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk përmbajnë shkelje të cilat pretendohen në kërkesë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e arsytimit të aktgjykimimit të saj në mënyrë të qartë ka paraqitur konkludimet e saja përkitazi me veprën penale e cila i është vënë në barrë të dënuarit sipas aktakuzës, dhe për më tepër, duke u bazuar në dispozitën e nenit 142 të LP të RSFJ-së, ka gjetur se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale. Në rastin konkret me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementet të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar i dënuari, meqë veprimet e tij kanë qenë të drejtuara ndaj popullatës civile dhe në cilësi të pjesëtarit rezervë të forcave policore serbe të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, kishte kryer veprimet inkriminuese të përshkruara hollësisht në dispozitivin e aktgjykimimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën e tij përkundër faktit se potencon shkeljen e dispozitës së nenit 370 par.7 të KPPK-së, mirëpo në asnjë pjesë të kërkesës nuk konkretizon shkeljet e pretenduara, por vazhdimisht potencon aspekte të gjendjes faktike të theksuara nga ana e gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore. Nga kjo

arsye duhet theksuar faktin se dispozita e nenit 370 par.7 të KPPK-së, ka përcaktuar disa shkelje të cilat ndërlidhen me arsyetimin e dhënë. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet fakti se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm përkitazi me faktet vendimtare dhe veçanërisht për faktin se cilat prova i ka konsideruar të vërtetuara dhe të pavërtetuara. Bazuar në shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë përveç provave të propozuara nga ana e prokurorisë, ka aprovuar propozimet e mbrojtjes duke marrë në pyetje dëshmitarët M.Sh, N.Sh dhe A.Q, me ç'rast ka trajtuar me kujdesin maksimal dëshmitë e tyre përkitazi me alibinë e të dënuarit. Në këtë mënyrë arsyetimin e dhënë në faqen 25-28 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë për faktin se në mënyrë të mjaftueshme janë elaboruar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve duke u ndërlidhur me provat tjera të administruara dhe ka ardhur në përfundim se pretendimet përkitazi me alibinë përkatësisht mos prezencën e të dënuarit ditën kritike, janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykatat e instancave më të ulëta e posaçërisht gjykata e shkallës së parë si gjykatë e faktit në mënyrë të gjithanshme kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha provat e administruara dhe po ashtu edhe përkitazi me mbrojtjen e të dënuarit. Ashtu që siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj dhe të cilin konstatim e aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë, skeleti i akuzës bazohet në dëshmitë e të dëmtuarve përkatësisht dëshmitarëve S. dhe J.Sh, andaj me të drejtë dëshmitë e tyre kanë qenë dëshmi vendimtare në këtë çështje penale. Në këtë mënyrë pretendimi i paraqitur në kërkesë përkitazi me dëshmitë e dëshmitarëve- të dëmtuarve J. dhe S.Sh, dhe fakti se dëshmitarët kanë pasur pasaktësi gjatë dëshmimeve të tyre, përkatësisht kanë paraqitur dëshmi të pa vërteta bazuar në dëshmitë e tyre gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale. Megjithatë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i tillë nuk është i bazuar. Fillimisht gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyetim për faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale deri në fillimin e procedurës penale ndaj të dënuarit kishin kaluar disa vite dhe se arsyetimi i paraqitur për faktin se dëshmitarët mos paraqitjen e rastit e kishin bërë për arsye të sigurimit të fakteve përkitazi me të dhënat personale të plota të tij, pasi që nuk posedonin të dhënat e plota për identitetin e tij. Megjithatë, dëshmitarët që nga paraqitja e kallëzimit penal dhe deklaratimet e tyre të mëvonshme deri në shqyrtimin gjyqësor kanë qenë të bindur në faktin kryesor se pikërisht i dënuari ishte kryerës i kësaj vepre penale dhe se nuk kishin asnjë mëdyshje përkitazi me këtë fakt. Për më tepër, dëshmitarët e njihnin mjaft mirë të dënuarin që nga periudha e para luftës dhe atë si punëtor ndihmës i personit Zh.M (fqinjë i dëshmitarëve) të cilit i ndihmonte në punët e bujqësisë. Nga kjo rrjedhimisht del i provuar fakti qenësor se dëshmitarët ishin mjaft të sigurt për faktin se

kryerës i kësaj veprë penale ishte pikërisht i dënuari. Nuancat e mangësive dhe pasaktësive të vogla në deklaratimet e tyre për shkak të faktorit kohë janë të papërfillshme, siç me të drejtë potencohen nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mirëpo e rëndësishme mbetet fakti kryesor se deklaratimet e tyre ishin konsistente në tërësinë e tyre.

Theksimet e paraqitura në kërkesë nga ana e mbrojtësit të të dënuarit përkitazi me pasaktësinë dhe paqartësinë e deklaratimeve të dëshmitarëve gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale, sipas pikëpamjes së Gjykatës Supreme të Kosovës, janë të pabazuara dhe me tendencë të paraqitjes së pjesëve të dëshmive të tyre, duke aluduar se edhe tërësia e dëshmive të tyre ishte e pabesueshme. Përndryshe dëshmitë e dëshmitarëve duhet vlerësuar në tërësinë e tyre dhe jo në pjesë të veçanta dhe të shkëputura, ashtu siç pretendohet nga ana e mbrojtësit të të dënuarit. Dëshmitarët J. dhe S.Sh, gjatë dëshmive të tyre kanë përshkruar në tërësi ngjarjen e datës 21.05.1999, duke filluar nga fakti se në shtëpinë e tyre kishin shkuar disa pjesëtar të policisë dhe pastaj e përmendin faktin se fillimisht *“... një pjesëtar i nacionalitetit rom menjëherë ka filluar ti rrah, përfshirë edhe një hollues deri sa ishte thyer e njëjta e pastaj ka ardhur N., i cili ka filluar ti rrah deri sa e ka ba llom, duke e goditur në krah, shpinë, këmbëve ka fundi edhe në duar...”* (faqja e dhjetë e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë). Nga kjo rrjedh se nëse dëshmitë e dëshmitarëve vlerësohen në tërësinë e tyre, atëherë del se janë dëshmi të besueshme dhe konsistente, siç kanë ardhur në përfundim gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore dhe të cilat konkludime i aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë.

Sa i përket procedurës së identifikimit gjithashtu është paraqitur arsyetim i mjaftueshëm në faqen 19-21 të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për më tepër, procedura ishte zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe në zbatim të plotë të dispozitës ligjore të përcaktuar me nenin 120 të KPPK-së. Dëshmitarët fillimisht kishin bërë përshkrimin e të dënuarit dhe karakteristikat e tij dhe pastaj u ishin ofruar fotografi të dhjetë personave me tipare përfaqësues të ngjashëm për nga mosha dhe fakti i pasigurisë së dëshmitarit S.Sh1, në identifikim, në asnjë mënyrë nuk e bëjnë të pabesueshme pjesën tjetër të dëshmisë së tij, kjo për faktin se dëshmitarët e kishin njohur të dënuarin edhe më parë dhe kishin pasur disa herë kontakte me të (të cilin fakt nuk e konteston as vet i dënuari gjatë mbrojtjes së tij).

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, bazuar në përmbajtjen

e saj, janë paraqitur pretendime edhe për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, meqë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se duke u referuar në bazën e kërkesës është theksuar për shkak të për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, mirëpo në kërkesë janë paraqitur pretendime vetëm përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendime është dhënë përgjigje në pjesën e mësipërme të këtij aktgjykimi.

Nga sa u parashtrua më lartë del se pretendimet e theksuara në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë ishin të pabazuara, andaj Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.280/2021, më 06 shtator 2021

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj